



Të dashur studentë dhe personel akademik i Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”!

Fillimi i këtij viti të ri akademik na gjeti larg auditoreve tona, për shkak të respektimit të masave të ndërmarra për ndalimin e përhapjes së infeksionit të COVID-19. Semestri i dytë i vitit akademik 2019-2020 dhe fillimi i vitit akademik 2020-2021, janë të pazakontë, aspak të lehtë, në një situatë e cila është përhapur anembanë botës, ku mosriktimi në auditore, është një domosdoshmëri.

Duke filluar nga data 2 nëntor 2020, e gjatë gjithë muajit nëntor, ne do të zhvillojmë procesin mësimor në distancë, duke përdorur platformat e dedikuara për këtë metodologji të mësimdhënies. Sfida është e përbashkët.

I nderuar personel akademik i Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, më lejoni që si mjek dhe si Rektori juaj, t’ju falenderoj për të gjithë punën e palodhur jo vetëm në detyrën tuaj sublime, por edhe për bashkëpunimin e kujdesin që keni treguar ndaj studentëve e njëri tjetrit. Ju faleminderit që gjithnjë jeni të gatshëm për t’u përshtatur të papriturave dhe për të realizuar me sa më shumë sukses punën tuaj të përditshme!

Të nderuar studentë, të cilët për herë të parë bëheni pjesë e Universitetit të Elbasanit, ju urojmë mirëseardhjen dhe ju urojmë suksese! Edhe pse me një fillim akademik jo normal, unë kam bindjen se ky do të jetë vetëm fillimi i një udhëtimi triumfesh e suksesesh për ju.

Suksese dhe shëndet për ju dhe familjet tuaja!

Prof.dr. Skender TOPI